

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE, TIRANE

Nr. 361 Rep.

Nr. 112 Kol.



KONTRATË SHITJE KUOTE

Në Tiranë, sot më 15/01/2020, para meje Julian Zhelegu, anëtar i Dhomës së Noterëve të Tiranës, me adrese ne rrugen “Pjeter Bogdani”, nr. 13, u paraqiten palët e kësaj Marrëveshjeje si më poshtë:

Shitësi: **Znj. Solida Mejdani**, shtetase shqiptare, lindur me 21.09.1983 ne Laç, Kruje, banuese ne Tirane, mbajtëse e leternjoftimit me nr. 030207582 dhe nr. Personal I359210450, madhore e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

dhe

Blerësi: **Z. Bledar Mejdani**, shtetas shqiptar, lindur me 20.04.1980 ne Vlore e banues ne Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 024454395 dhe nr. Personal I004220206T, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

MEQENESE:

- Shitësi zotëron 100% te Kapitalit te Shoqërisë “AL - COMM” Sh.p.k, një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L21931007A, me seli ne adresen: Njesia Bashkiake nr.1, Rruga Petro Nini Luarasi, Zona Kadastrale 8160, Njesia me nr.3/943-N2, Tirane, (me poshte referuar “*Shoqëria*”);
- Shitësi deshiron t’i shese Bleresit dhe Bleresi deshiron te bleje nga Shitësi 50% te kapitalit qe Shitësi zoteron ne shoqerine e siperpermendur;
- Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkelidhur te Ortakut te Vetem te Shoqerise, Palet deshirojne te lidhin kete Kontrate.

PER SA ME SIPER, palët bien dakord si vijon:

- Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Shitësi i shet Bleresit dhe Bleresi blen nga Shitësi 50% (pesedhjete e nje perqind) te kapitalit te Shoqerise “AL-COMM” Sh.P.K. Shitësi deklaron dhe garanton se ka marrë nga Blerësi, në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord prej 50.000 Leke (pesedhjete e nje mijë leke) perpara nenshkrimit te kontrates dhe për këtë arsye transferon këtu 50% te kapitalit te zotuar prej tij në Kapitalin e Shoqërisë, në pronësi të Blerësit. Shitësi deklaron e garanton se nuk ka asnje pretendim te cfaredolloji ne lidhje me pagimin e cmimit te shitjes dhe shprehimisht heq dore nga cdo pretendim i mundshem. Palet



deklarojne e garantojne reciprokisht njera-tjetren se cmimi i shitjes se kuotave eshte i drejte, i arsyeshem dhe i caktuar me vullnetin e lire e te plote te paleve.

Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se pjeset e kapitalit te transferuara ketu, janë ne pronesine e tij te plote e ligjore dhe te lira nga barra hipoteke apo pengje.

3. Bleresi blen 50% te kapitalit te Shoqerise dhe me nënshkrimin e kësaj Kontrate struktura e ortakeve ne shoqeri do te jete:

Znj. Solida Mejdani mbetet ortake me 50 % te kuotave te kapitalit;

Z. Bledar Mejdani behet ortak me 50 % te kuotave te kapitalit;

4. Blerësi pranon pronësinë e Kuotes duke njohur gjendjen e Shoqerise dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i kuotes, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit.
5. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit te Kuotes objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të ligjit.

Kjo Kontrate u hartua në 3 (tre) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe. Kontrata bazohet në nenin 705 e vijues të Kodit Civil dhe në Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar. Kontrata u lexua përpara palëve, u gjet e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht nga palët si vijon:

PALET

SHITESI

BLERESI

NOTERI

JULIAN ZHELEGU



**VENDIM
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE
“AL-COMM” Sh.P.K.**

Sot, me date 15 Janar 2020, Ortaku i Vetem i Shoqerise “AL-COMM” Sh.P.K. (ne vijim “Shoqeria”), një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L21931007A, me seli ne adresen: Njesia Bashkiake nr.1, Rruga Petro Nini Luarasi, Zona Kadastrale 8160, Njesia me nr.3/943-N2, Tirane, ne perputhje me Statutin dhe Ligjin 9901/2008, te ndryshuar,

VENDOSI:

1. Te miratoje shitjen e 50% (pesedhete e nje perqind) te kapitalit te zoteruar nga ortaku i vetem i shoqerise Solida Mejdani ne favor te bleresit Bledar Mejdani.

Ky Vendim u miratua dhe u nenshkrua rregullisht nga ortaku i vetem i Shoqerise si me poshte vijon:

**ORTAKU I VETEM
SOLIDA MEJDANI**

